

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, sipas gjykatësit Raif Fazliu, me sekretaren juridike Mejreme Uka, në çështjen juridike të paditësit D. Z. nga Klllokoti, të cilin me autorizim e përfaqëson E. P., av. ne Viti, kundër të paditurës Komuna e Klllokotit, ne Klllokot, të cilën e përfaqëson i autorizuari Mi. St.– drejtor i Drejtorisë për Arsim, Shendetësi, Kulturë, Rini dhe Sport, me bazen juridike ndërprerja e mardhenjes se punës ne menyre të kundërligjshme, pagesa e te ardhurave personale, në shqyrtimin e mbajtur kryesor, në praninë e palëve ndërgjyqëse me datë 30.03.2015, bie këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET kërkesëpadia e paditësit D.Z nga Klllokoti, **VËRTETOHET** se Vendimi i Kryetarit të Komunës së Klllokotit nr.XX i dates XXX është kundërligjor, **DETYROHET** Komuna e Klllokotit që paditësit t`ia kompensoj të ardhurat mujore në shumë prej XXX euro, nga data XXX deri më XXX, duke i llogaritur me kamaten mujore prej 8%, e gjithë kjo brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërinë së këtij aktgjykimi, nën kërcnimit e permbarrimit të dhunshem.

II. REFUZHET kërkesëpadia e paditësit për Kthimin e tij ne vendin e punës.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A s y e t i m

Paditësi D.Zd., nga Klllokoti, në padi dhe kërkesëpadi kërkon që e paditura Komuna e Klllokotit, respektivisht Drejtoria për Arsim, Shendetësi, Kulturë, Rini dhe Sport e kesaj komune, t`ia paguaj të ardhurat personale mujore, nga data ..., deri në skadimin e kontratës mbi punën me kohë të caktuar me datë xxx, me kamatë mujore prej 8 %, nga dita e paraqitjes se padisë në gjykatë me xxx, deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedures kontestimore. Ai kishte themeluar mardhënje pune ne kohë të caktuar në shkollën fillore "S. S." në Klllokot, ne vendin e punes si punëtor ndihmës.

E paditura në përgjigjen ne padi ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit, me faktin se kontrata e lidhur mes të paditurës Komuna e Klllokotit, si punëdhës dhe paditësit, D.Z., si punëmarrës, është në kundërshtim me nenin 8, pika 1 dhe 2. Të Ligjit për Punë, 03/L-2012. Në dokumentacionin e te paditures nuk ekziston dëshmi se per kete vend pune ishte shpallur konkurs publik.

Gjithashtu paditësi ne padi paditësi deklaroi se Vendimi i Kryetarit të Komunes së Klllokotit nr.xxx, i dates xxx, per anulimin e disa kontratave në drejtorinë për Arsim,

Shendetësi, Kulturë, Rini dhe Sport, ishte i kundërligjshëm, nuk qendron, nga se neni 58, pika g). të Ligjit për Qeverisje Lokale, parashifet që kryetari i komunës menaxhon me politiken e komunes dhe nuk potencohet se ai nuk mund të anuloi kontrata individuale. Andaj pasi kryetari kishte formuar komisionin për verifikimin e kontratave në atë drejtori, ky komision në raportin e vetë nr.xxx, datë xxx, doli se ky punëtor nuk ishte pranuar në punë me konkurs publik. Padiësi ka themeluar marrëdhënie punë me kohë të pacaktuar në shkollën fillore "xxx" në xxx me cilin funksionon me sistemin e Rep. së Serbisë dhe punon si roje nate, i cili merr pagën mujore dhe në të njëjtën kohë ai nuk mund të ketë dy punëdhënës. E paditura përmes përgjigjes në padi kishte propozuar që padiësin të refuzohet kërkesëpadija.

Përfaqësuesi me autorizim i padiësit, avokati E. P., në shqyrtimin e mbajtur përgatitor me xxx, ka deklaruar se i konteston shpjegimet në përgjigje në padi nga e paditura, sepse neni 58 pika g). të Ligjit për Qeverisje Lokale, nuk paraqet dhe nuk jep bazë për anulimin e një punë juridike të lidhur, sepse kjo dispozitë parashfë organizimin dhe udhëheqjen e punës politike në komunë, që do të thotë se kjo dispozitë nuk ka parapare mundësinë e anulimit të kontratave. Andaj edhe vendimi për anulimin e kontratës e cila kishte ekzistuar, është i kundërligjshëm. Me këtë vendim padiësin iu kishin ndërprerë të ardhurat personale, pa u njoftuar fare me vendimin, që mund të vertetohet edhe në fund të tij, kur thuhet se vendimi u dorëzohet Arkivit dhe Drejtorit të drejtorisë, por jo edhe punëtorit.

Përfaqësuesi i të paditurës Komuna e Klllokotit, i autorizuari M. S.– drejtor i Drejtorisë për Arsim, Shendetësi, Kulturë, Rini dhe Sport, kishte propozuar refuzimin e kërkesëpadiës, sepse nuk ka bazë ligjore dhe nuk mund të argumentohet, se padiësi kishte themeluar marrëdhënie punë me anë të konkursit publik. Ai ishte shprehur krejtësisht sikur në përgjigjen e dhënë në padi. Ky padiës me heret kishte pasur marrëdhënie punë legale me këtë drejtori, por me kërkesën e vetë iu kishte ndërprerë, ku ky përfaqësues i dorëzoi gjykatës aktvendimin e datës xxx, por i njëjti ka kontratë mbi punën dhe punon si punëtor teknik-rojtar nate në shkollën fillore "xx" në xxx të cilin e paguan Rep. E Serbisë, vendimi nr. xxx datë xxx dhe xxx, datë xxx. Andaj, është e pamundur që ky punëtor të punoj në dy vende punë, por punon vetëm si roje nate.

Përfaqësuesi me autorizim i padiësit, avokati E.P.i kundërshtoi aktvendimet nr. 1.., datë .. dhe .. datë xxx si provë jo relevante, sepse këto aktvendime janë të para kohës se lidhjes së kontratës, sepse kontrata është lidhur me xxx.

Përfaqësuesi i të paditurës Komuna e Klllokotit, kishte propozuar dhe iu kishte miratuar propozimi që në seancën e radhës të degjohet Z. S. në cilësinë e deshmëtarit, i cili punon si punëtor ndihmës në Komunën e Klllokotit. Propozimin nuk e kishte kundërshtuar pala padiëse. Obligimin për ta ftuar deshmëtarin e kishte marrë pala e paditur, e cila ishte edhe propozuese.

Ndërsa në shqyrtimin e mbajtur kryesor me 30.03.2015, padiësi D. Z.ka mbetur në tërësi pranë padiës dhe kërkesëpadiës. Në këtë seancë nuk ishte paraqitur përfaqësuesi i padiësit.

Përfaqësuesi i të paditurës kishte theksuar se paditesi ka qene dashur ta lexoj kontraten mbi punen para se ta nënshkruaj ate, sepse ai nuk ka guxuar dhe nuk mundet te njeften kohe ti kryej dy punë.

Por paditesi pas kesaj deklarate kishte theksuar se sa e di une kishte pasur konkurs publik, por mua vetem me ishte thenë qe ta nënshkruaj kontraten, nga drejtori i drejtorisë. Ndersa, kam hequr dore te punoj ne institucionet e Rep. se Kosoves, kur kam dhene deklarate me xxx per shkak se isha i kërcnuar, se do te me largojnë nga puna, po qe se pranoj te punoj në sistemin e Rep. se Kosoves.

Leximi dhe shtjellimi i provave:

-Lexohet kontrata mbi punen me kohe te caktuar, e dates xxx e nenshkuar ndermjet M. S., ne emer te punëdhensit, ne njeren ane dhe punëmarrësit ne anen tjetër, lexohet procesverbali i komisionit per verifikimin e dosjeve ne departamentin e arsimit, i dates xxx, lexohet vendimi nr.xx date xxx, i nenshkuar nga Kryetari i Komunes se Kllokotit, lexohet pergjigja ne ankesë, nr.xxx, datë xx nga drejtori i arsimit A. S., lexohet aktvendimi nr.xxx date xxx per shpalljen e vendit te punes, si roje nate me kohe te pa caktuar, ne shkollen fillore "xxx" ne xxx. Lexohet aktvendimi i te ardhurave personale nr...date ... dhe lexohet deklarata e paditesit e dates xxx dhe vendimi pas kesaj deklarate i dates xxx, nga drejtori M. S..

Palet nuk i kishin kundërshtuar provat.

Fjala perfundimtare e paleve:

Paditesi D. Z. ne fjalen perfundimtare kishte propozuar gjykates qe t`ia miratoj kërkesepadine, ashtu qe e paditura tia paguaj gjitha pagat nga dita kur ishte larguar nga puna, deri ne pagesen definitive dhe ta kthej ne vendin e punes sipas kontrates qe ishte pranuar ne punë.

I autorizuari i te paditures Komuna e Kllokotit, kishte propozuar qe ta refuzoi kerkesepadine e paditesit, sepse nuk kishte patur kurrfar mardhenje pune, por kontrata ishte fiktive, sepse nuk ishte shpallur konkurs publik, siç e thot Ligji per Punen, kurse punet dhe detyrat nuk i ka kryer paditesi, sipas kontrates.

Gjykata e ka bërë vlerësimin e provave veç e veç dhe si tërësi, konform nenit 8 të LPK-së..

- Me leximin e kontratës mbi punen me kohe te caktuar, e dates xxx, e nenshkuar ndermjet M. S., në emer te punëdhënsit, ne njeren ane dhe punëmarrësit D. Z., ne anen tjetër, gjykata konstaton se me këtë veprim palet kontraktuese kishin marr te drejta dhe obligime, per kohe te caktuar, sepse kjo kontratë i përmbanë ne vehte gjitha elementet që duhet t`i ketë kontrata. Aty ishin paraparë vendi i punes, fondi i oreve te punes, data e fillimit te zbatimit dhe mbarimi i kontrates, paga mujore, si dhe gjitha elementet tjera përcjellëse, deri te nenshkrimi i palëve kontraktuese.

- Me leximin e procesverbalit te komisionit per verifikimin e dosjeve ne departamentin e arsimit, i dates xxxxx, gjykata konstaton se ky komision ishte themeluar per t`i verifikuar kontratat e punes ne departamentin e arsimit dhe shendetësisë, së Komunes se Kllokotit.

- Me leximin e Vendimi nr.xx date xx, i nenshkuar nga Kryetari i Komunes se Kllokotit, konstatohet se ky vendim iu ishte dedikuar 23 punëtorëve, kryesisht arsimorë dhe shendetesorë, por kishte edhe sherbyes civilë, të cilëve sipas ketij vendimi nuk iu

ishite komunikuar (dorëzuar) fare, sepse ne fund te vendimit thuhet ai i dorëzohet arkivit dhe drejtorit te drejtoratit, por jo edhe punëtorit. Këtë e dëshmon prova:

- Ankesa e paditesit D.Z., nr.xxx e dates xxx ku paditesi kishte kerkuar me nje vonesë relativisht te madhe që t`iu vazhdohet pagesa e pages mujore, ndersa

- Pergjigja ne ankesë, nr.xxx, datë xxx nga drejtori i arsimit A. St., deshmon se pergjigja ishte bere ndaj ankuesit, tani paditesit se konkurs publik nuk kishte pasur dhe **se permes kesaj pergjigje edhe iu ishte derguar edhe vendimi per anulimin e kontrates se punes.**

- **Në fund** aktvendimi nr.xx, date xxx, per shpalljen e vendit te punes, si roje nate me kohe te pa caktuar, ne shkollen filllore "xx" ne xx pastaj aktvendimi i te ardhurave personale nr.xxdate xxx dhe deklarata e paditesit e dates xxx dhe vendimi pas kesaj deklarate i dates 0xxx, nga drejtori Mx Sx, nuk janë vlerësuar si prova relevante nga gjykata, sepse keto prova nuk kanë kauzalitet me rastin konkret.

Natyrisht gjykata rëndësi te veçantë dhe prove dominuese ndaj provave tjera, e ka vlerësuar kontratën mbi punen me kohe te caktuar, e dates xxxx, e nenshkruar ndermjet palëve kontraktuese.

Gjykata tërë këtë raport juridik mes palëve kontraktuese u shërbye me të drejtën materiale, siq është neni 28, i LMD-së, sepse vullneti i palëve ka fuqi detyrimi dhe është mbi ligjin – autonomia e vullnetit, duke shtuar se ajo që kontraktuesit kanë percaktuar me kontratë – është ligj për ta. Pastaj parimi i ndershmërisë dhe ndërgjegjshmërisë dhe objekti i kontrates ishin te lejueshme nga palët. Po ashtu kontrata ishte lidhur në formën e caktuar me ligj.

Por kjo kontratë edhe pse i permbante gjitha elementet, duke perfshirë edhe legjitimitetin e pales si punëdhenes, ajo nuk ishte pranuar nga një pushtet i ri, edhe pse në kontinuitet ka qenë dashur të vazhdoj të përmbushet, deri më datë xxx.

Pretendimet e pales se paditur se kontrata e punes nuk ishte burim i konkursit publik, nuk eshte shume domethenese për palen paditese, sepse ajo ishte e ndërgjegjshme dhe e përgjegjshme per tiu permbajtur. Tek e fundit konkursi publik nuk prodhon te drejta, as detyrime për palët, por kontrata, e cila eshte punë juridike e dy anshme, ku ka krijuar te drejta dhe detyrime, per palët.

Pastaj pretendimi i te paditurës, se paditesi nuk ka mundur ti kryej dy pune ne te njejten kohë, nuk qendron nga se e paditura nuk ka zhvillu kurrfar procedure për ndonje shkelje disiplinore, ndaj paditësit. Ajo edhe vendimin mbi anulimin e ketyre kontratave nuk ia kishte dorëzuar individualisht-personalisht paditësit, por kete e kishte bërë me një vonesë prej dy muajve dhe dy javëve, respektivisht me date xxxx.

Gjykata ka refuzuar kerkesëpadinë e paditësit, sikur në pikën II. të dispozitivit te ketij aktgjykimi, per kthimin e tij ne venndin e punes sipas kontrates (qe e kishte kerkuar në fjalen perfundimtare), me arsyetimin se kontrata ishte me kohe te caktuar, deri më xxxx.

Gjykata sa i përket vazhdimit të kontratës mbi punën, konstaton se kjo kërkesëpadi është e pa bazuar për arsye se vazhdimi i kontratës të punës mund të bëhet vetëm me vullnetin e të dy palëve (punëdhënësit dhe punëmarrësit) dhe pasi që në rastin konkret ka munguar vullneti i të paditurës si punëdhënës për ta vazhduar këtë kontratë, e njëjta nuk është vazhduar dhe gjykata nuk ka të drejtë që në rastin konkret

ta obligoj punëdhënësin që paditësit t'i vazhdoj kontratën e punës pas skadimit të kontratës paraprake.

Në bazë të të cekurave të lartshënuara u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore nuk është marr pasi që paditësi nuk i ka kërkuar këto shpenzime duke i specifikuar dhe është vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA NË VITI

C.nr. 169/2014

Më:30.03.2015

Gjyqtari
Raif Fazliu

UDHËZIMI PËR MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.